



Ndal Punës së Fëmijëve

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve  
nëpërmjet edukimit,  
artit dhe medias

Kolazh



**Objektivi:** Realizimi i dy kolazheve, i pari me një temë të përgjithshme dhe i dyti me temë për punën e fëmijëve.



**Përfundimi:** Nxitja e aftësive shprehës artistike, si dhe tërheqje e vëmendjes së shtypit për mangësi të trajtimit të problemeve lidhur me punën e fëmijëve.

## Koha

*1 ose 2 orë mësimi*

## Motivimi

Qëllimi kryesor i kësaj veprimtarie është t'i ndihmojë të rinjtë të perceptojnë natyrën "e fshehtë" të punës së fëmijëve, e cila, nuk është e lehtë të perceptohet në jetën e përditshme.

Në shoqërinë e sotme, figura dhe shembujt e ndryshëm flasin vetë, aq më tepër kur u drejtohen të rinjve. Forma me të cilën mjetet e komunikimit u drejtohen të rinjve, janë pothuajse si ilustrimet vizatimore të fëmijëve. Ka shumë fotografi, vizatime, grafika dhe pak tekste.

Qëllimi i mjeteve të komunikimit, si: televizioni, filmi, videot, lojërat në kompjuter etj., është të tërheqin vëmendjen e të rinjve duke u dhënë mundësinë të udhëtojnë ndërmjet figurave dhe imazheve të shpejta me ndikime të veçanta. Në të gjitha këto figura dhe imazhe, mbizotëron veprimi, ndërsa fjalët janë të pakta. Shoqëria e sotme ka krijuar një brez të rinjsh, motoja e të cilëve është: "Dua gjithçka dhe e dua tani. Dua më të mirën dhe menjëherë".



## Shënim për përdoruesin

Moduli i kolazhit mund të hapë siparin e realizimit të moduleve të programit. Nuk është kusht i rëndësishëm që pjesëmarrësit të jenë të informuar për punën e fëmijëve. Vetë moduli është një pikënisje e mirë për të diskutuar dhe për të mbajtur qëndrim për punën e fëmijëve në mënyrë të thjeshtë, argëtuese dhe krijuese, stil ky që karakterizon realizimin e të gjitha moduleve.



### Ç'është kolazhi?

Kolazhi është një mozaik i përbër nga fotografi, figura, copa teksti të prera nga revista, gazeta dhe libra të ndryshëm, postera dhe figura vizatimore, libra të ilustruar etj., që ngjiten në një tabak letre, në mënyrë të tillë që të japin një figurë të re. Ky krijim i ri duhet të pasqyrojë një temë të caktuar.

Përgatitja e kolazhit është një veprimtari e këndshme që nxit humorin dhe pjesëmarrjen e adoleshentëve. Puna përfundon me krijimin e një imazhi të kënaqshëm dhe të pranueshëm nga të gjithë. Për realizimin e tij, duhet të keni ngjitëse, gërshërë, ngjyra, penela dhe çfardoltoj materiali që do t'u shërbejë të rinjve për të mbushur tabakun e letrës.

Nga ana tjetër, imazhet dhe figurat që tregojnë punën e fëmijëve në të gjithë botën, janë shumë të pakta, madje edhe në ato vende ku kjo dukuri është shumë e përhapur.

Mungesa e kësaj transparence duhet të kërkohet pjesërisht në ndërgjegjësimin e paktë të shoqërisë ndaj kësaj dukurie dhe pjesërisht në dëshirën e shumëkujt që të mos e vlerësojë problemin: "A punojnë fëmijët?", "Jo!", "Po ku punojnë?", "Mos fol dokrral!". Është me të ertetë për t'u habitur. Sot, numri i fëmijëve që punojnë, është afërsisht sa popullsia e ShBA-së dhe, megjithatë, njerëzit nuk e kuptojnë ose bëjnë sikur nuk e kuptojnë që puna e fëmijëve është e pranishme. Mendoni si do të ndiehej një vend me 250 milionë banorë që do t'i mohojë prania e tyre?

Një ndër detyrat që i kemi vënë vetes, në kuadër të realizimit të veprimtarive edukative, është të zbulojmë një plagë të shoqërisë, siç është puna e fëmijëve. Pra, objektivi i veprimtarisë është t'u tregojmë të rinjve sa hapësirë të vogël zë në mjetet e informimit masiv dukuria e punës së fëmijëve dhe sa e nevojshme është që kjo pjesë e shoqërisë të ketë një fytyrë që ta shohin të gjithë.

## Mjetet që nevojiten

Materialet që nevojiten, gjenden me lehtësi (sasia e tyre varet nga numri i pjesëtarëve në grup).

Revista të përdorura me ngjyra, bardh e zi, të përmasave të ndryshme (gjendja në të cilën janë reavistat, nuk ka fare rëndësi);

Gazeta dhe libra të përdorur, libra vizatimorë, postera, fletëpalosje;

Tabakë të mëdhenj letre me ngjyra ose të bardhë, të renj ose të përdorur, fletë të gazetave të vjetra që mund t'i përdorni si sipërfaqe ku do të ngjisni figura të ndryshme;

Gërshërë të madhësive të ndryshme, vizore me buzë të drejta ose të dhëmbëzuara për të prerë figurat e ndryshme;

- ✓ Ngjitëse të llojeve të ndryshme, të lëngshme ose letër.
- ✓ Ngjyra të ndryshme, pastel, bojëra uji, lapsa me ngjyra etj.
- ✓ Një klasë ose dhomë me sipërfaqe të lirë ku mund të shtrini tabakët e letrës ( edhe në dysheme nëse nuk ka një zgjidhje më të mirë). Është mirë që dhoma të jetë e ajrosur, meqë do të përdorni ngjitës të ndryshëm;
- ✓ Sipërfaqe muri bosh ku do të ngjisni kolazhin pas përfundimit.



## Përgatitja

Për realizimin e veprimtarisë, të ndiqni këto rregulla.

### *Materialet*

- Sigurohuni të keni materiale të bollshme, veçanërisht gazeta dhe revista. Sigurisht kjo varet nga kushtet në të cilat ndodheni, por mos u mërzisni, mund t'ju shërbejnë edhe materiale shumë të thjeshta.
- Në gjetjen e materialeve, aktivizoni edhe të rinjtë. Ata mund të sjellin nga shtëpia materiale të tilla.
- Vetë të rinjtë mund të japin mendime për vende ku mund të gjenden materiale të tilla, si: shtëpi botuese, shtypshkronja, punishte, redaksi gazetash, vende ku riciklohen materialet.
- Duke e ndjerë vetën të përfshirë, te të rinjtë do të rritet motivimi, interesi dhe kënaqësia e tyre për të marrë pjesë në procesin e sigurimit të materialeve.
- Do të nxitet kurioziteti i të rinjve për atë që do të bëjnë me këto materiale.



### *Titujt e kolazhit*

- Mendoni për tituj të ndryshëm për të emërtuar kolazhin.
- Shkruajini të gjithë titujt që keni gjetur, dhe gjatë takimit të parë, nxitini të rinjtë të propozojnë temat e marketingut.
- Nëse të rinjtë nuk arrijnë t'i gjejnë vetë titujt (gjë që është e pamundshme), ju mund të propozoni tituj që i keni paramenduar.

## Zhvillimi i modulit



Grupet duhet të përgatisin dy kolazhe. I pari, të jetë me temë të zakonshme, si, p.sh.: "Pushimet verore", "Muzika që më pëlqen", "Vendi ynë", "Familja jonë", "Shokët e mi". I dyti, të jetë me temë për punën e fëmijëve.

Para se të filloni punën, shpjegojuni hollësisht pjesëtarëve të grupit se çfarë do të bëjnë. Në këtë fazë, mos zbuloni temën e kolazhit të dytë. Do t'u thoni të rinjve thjesht se do të përgatisin dy kolazhe. Bëhet fjalë për një ushtrimi të thjeshtë dhe argëtues që ata duhet ta kryejnë me kënaqësi. Merrni masa që të gjithë të rinjtë të marrin pjesë në mënyrë aktive.

### *Organizimi i grupit*



Në varësi të madhësisë së grupit, si dhe në varësi të mjedisit dhe materialeve që keni, grupi mund të ndahet në disa nëngrupe. Nëse grupi është i vogël, ka vetëm 4-5 të rinj, mund të punojnë në çift ose më vete, në mënyrë të pavaruar. Është mirë që çdo nëngrup të mos ketë më shumë se 5 veta. Sigurohuni që asnjë të mos tërhiqet, por të marrë pjesë në punën në grup. P.sh., dy të rinj merren me shfletimin e revistave për të gjetur figurat, të tjerë, i presin me gërshtë dhe, po të tjerë, i ngjisin në tabakun e letrës. Gjithçka duhet të zhvillohet në një klimë miqësore dhe bashkëpunuese.

## Veprimtaria 1. Kolazh i përgjithshëm

1 orë mësimi

Propozojini grupit të përgatisë një kolazh me një temë që ka zgjedhur vetë, sigurojini materialet e duhura dhe shpjegojani se çfarë është kolazhi, nëse nuk e dinë. Nxisni diskutimin ndërmjet pjesëtarëve të grupit për titullin. Shkruani disa prej tyre në dërrasën e zezë ose në një tabak letre dhe, lëri në rinjtë të zgjedhin vetë temën.



Vendosni mjetet që duhen në një vend të përshtatshëm dhe jepuni rreth 20 minuta kohë pjesëmarrësve për përgatitjen e kolazhit. Mos u jepni shumë kohë, në mënyrë që të mos shpërqendrohen dhe të humbin interesin për veprimtarinë. Gjatë kohës që punojnë, kaloni nga një grup tek tjetri. Pyetini se çfarë kanë vendosur të bëjnë. Jepuni këshilla dhe bëni vlerësime kur ju duket e nevojshme, por gjithçka të zhvillohet në një atmosferë gazmore, pa seriozitet të tepruar.

Në përfundim të kohës që keni caktuar, ftojini të rinjtë të paraqesin punimet që kanë përgatitur (varini në mur ose në dërrasën e zezë në mënyrë që t'i shikojnë të gjithë). I gjithë grupi ose një përfaqësues i zgjedhur duhet të shpjegojë se çfarë kanë paraqitur në kolazhin e tyre. Nxisni komentet dhe pyetjet në lidhje me paraqitjen.


Për të gjallëruar më shumë atmosferën në grup, mund të përdorni edhe elemente të garës, si, p.sh.:

- Paraqitësit e punës nuk duhet të thonë titullin e kolazhit, të tjerët duhet të përpiqen ta gjejnë vetë atë.
- Zgjidhni kolazhin më të mirë me votim.
- Vlerësimi i kolazhit mund të bëhet nga një grup të rinjsh jashtë projektit apo nga të rinjtë e një klase tjetër, nëse jeni në shkollë.

Megjithatë, elementet e garës duhet të përdoren me kujdes. Objektivi që keni, është krijimi i një mjedisi miqësor, i qetë dhe bashkëpunues brenda grupit dhe jo veçimi e dallimi i atyre që nuk janë të aftë nga pikëpamja artistike të përgatisin një kolazh. Nëse mendoni se elementet e garës do të tensiononin punën në grup, mos i përdorni.

## Veprimtaria 2. Kolazhi për punën e fëmijëve

*1 orë mësimi*



Në përfundim të kolazhit të parë, pasi grupi është qetësuar, paraqitni temën e kolazhit të dytë që është për punën e fëmijëve. Në këtë fazë, mos shtoni asgjë tjetër. Para se të zhvilloni këtë modul, është mirë të keni zhvilluar modulën "Informacioni kryesor". Pra grupi ka krijuar një farë ideje për punën e fëmijëve. Veprimtarinë zhvillojeni në mënyrë të tillë që fëmijët të shfrytëzojnë sa më shumë imagjinatën dhe aftësitë e tyre krijuese. Mos shfaqni mendimin tuaj rreth temës, por t'i motivoni fëmijët të mendojnë rreth saj.

Shpjegojuni që ata duhet të realizojnë një kolazh ku të paraqitet puna e fëmijëve sipas mendimit të tyre. Duhet të veprojnë njësoj si në veprimtarinë e parë, pra të gjejnë figura nga revista, libra, gazeta, t'i presin dhe t'i ngjisin në një tabak letre (ndoshta do të duhet më pak kohë, pasi fëmijët nuk do të jenë shterues për këtë temë). Mbikqyrni mënyrën si do të punojnë pjesëtarët e grupit.

Dy janë situatat që mund të krijohen.

Situata e parë, grupi pasi të studiojë të gjitha materialet që ka, ndoshta nuk do të gjejë materiale të mjaftueshme për të paraqitur punën e fëmijëve. Kjo është pozitive, pasi



pikërisht këtë duam të arrijmë. Secili nga grupet do të përgatisë një kolazh, por që nuk do të jetë aq i pasur sa kolazhi i mëparshëm.

Situata e dytë e mundshme është që në grup të ketë pjesëtarë me një talent të dukshëm artistik, të gjallë dhe të ndjeshëm. Në këtë rast, do të jeni me fat, pasi kolazhi i përgatitur do të jetë një vepër e vërtetë arti.

Si dhe në kolazhin e parë, në përfundim, kolazhet e grupeve do të varen në mur, do të paraqiten nga i gjithë grupi ose nga përfaqësues të grupeve dhe të gjithë pjesëmarrësit do të ftohen të komentojnë dhe të diskutojnë rreth tyre. Nëse e shihni të vlefshme, mund të zgjidhni kolazhin më të mirë.

## Ç'duhet bërë dhe ç'duhet mënjanuar?

Mos lejoni të kritikohet dhe të vihet në pozitë të vështirë grupi që ka përgatitur kolazhin. Nënvizoni të gjitha anët pozitive të punës së kryer.

Lëri vend dialogut, garës, ngacmimeve, thumbimeve deri në atë masë që i keni nën kontroll.

Mos i jepni njërit grup më shumë ose më pak kohë për të përfunduar kolazhin. Qëllimi i punës së tyre nuk është krijimi i një vepre arti, por nëse prodhohet një e tillë, aq më mirë.

Përcaktoni kohën për përgatitjen e kolazhit. Gjatë përgatitjes kaloni nëpër grupe duke i kujtuar se duhet të respektojnë afatin kohor.

Varini në mure të gjitha kolazhet dhe ftojini të gjithë t'i shikojnë dhe të komentojnë punën e të tjerëve.



## Diskutimi përfundimtar

### 1 orë mësimi

Gjatë diskutimit përfundimtar është e nevojshme të shpjegoni se puna e fëmijëve përbën një ndër format e shkeljes së të drejtave të tyre dhe është një dukuri që po përhapet në botë. Mjetet e komunikimit i kushtojnë një hapësirë të kufizuar kësaj dukurie të tmerrshme që duhet ndaluar njëherë e përgjithmonë.

Në këtë mënyrë, grupi do të arrijë të kuptojë se është e lehtë të krijosh një kolazh për disa anë të lumtura të jetës, por nuk është aq e lehtë, kur bëhet fjalë për të luftuar dukuri negative. Edhe nëse ndonjë grup ka arritur të prodhojë një kolazh shumë të mirë për punën e fëmijëve, vështirësitë që ka hasur, janë më të shumta në krahasim me kolazhin e parë ku tregonin për dukuri pozitive të jetës.


Nxisni diskutimin në grup rreth faktit që puna e fëmijëve nuk është e dukshme. Pyetini të rinjtë se çfarë mendojnë për informimin e pakët që ka për këtë dukuri.

- Mendojnë se puna e fëmijëve është e gabuar?
- A duhet të jenë më të vëmendshme ndaj këtij problemi mjetet e komunikimit?
- A është një temë që bën "bujë"?
- Çfarë e përcakton se një lajm është i bujshëm apo jo?
- Ç'faktorë duhen marrë parasysh për të vendosur të botohet ose jo një material me fakte për punën e fëmijëve?
- Sa prej të rinjve në grup do të blenin apo do të shfletonin një revistë me artikuj dhe fotografi për punën e fëmijëve?
- Në çfarë përfundimesh mund të dalim për shoqërinë, për parimet dhe vlerat e saj në rastet kur jepen fakte të shfrytëzimit të punës së fëmijëve?

Një diskutim i tillë mund të jetë disi i rëndë, veçanërisht për adoleshentët që janë shumë të zënë me problemet e tyre, madje mund të ulte interesin e tyre për të bashkëpunuar apo për të marrë pjesë në veprimtaritë e ardhshme. Bëni të mundur që vetë fëmijët të diskutojnë, të shprehin mendimet dhe komente rreth temës. Në çastin e duhur ndërhyini për t'i nxitur të vazhdojnë. Ngrini çështje të reja që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, kryesisht ato që mendoni se kanë më shumë ose më pak akses në media, p.sh., konfliktet shoqërore dhe problemi i refugjatëve. Kërkoni të shprehen përse ndodh kjo, përse lajme të tilla bëjnë më shumë bujë se lajmet e tjera në lidhje me të drejtat e njeriut.

Bëni kujdes që grupi të mos ndihet i pafuqishëm ndaj këtyre problemeve. Nëse grupi i percepton këto probleme si shumë të vështira për t'i diskutuar dhe ndiehet i paaftë për të dhënë përgjigje, anëtarët e tij do të dekurajohen. Mundohuni të nënvizoni anët pozitive.

- Tashmë ata kanë filluar të ndërgjegjësohen.
- Ndoshta dëshirojnë të bëjnë diçka.
- Mund të përcjellin tek të tjerët atë ç'kanë mësuar.
- Si konsumatorë kanë edhe ata një rol për të luajtur.



## Vlerësimi dhe vazhdimi



Treguesit e realizimit të modulit lidhen me vlerësimin e përfundimeve të caktuara që janë arritur ose jo.

- Kolazhe me tematikë të ndryshme. Çdo grup duhet të përgatis një kolazh, ndoshta dhe jo shumë të mirë. Nëse nuk ka arritur të përfundojë një kolazh, ndoshta është e udhës që moduli të realizohet në një kohë tjetër, kur të rinjtë të jenë më të ndërgjegjësuar për problemin. Mund të ndodhë që grupi, me të cilin punoni, nuk është shumë aktiv. Mos u mërzisni, do të ketë module të tjera që do të nxisin interesin dhe pjesëmarrjen e duhur të të rinjve.
- Kolazhi për punën e fëmijëve. Në të dyja rastet kur të rinjtë realizojnë ose jo një kolazh, me këtë temë, arrihet një qëllim. Ajo që kërkohet, është që fëmijët të përballen me një detyrë dhe ta ndiejnë të vështirë, madje edhe të pamundshme për të kryer realizimin e saj. Gjithësesi, të gjitha kolazhet do të kenë kreativitet dhe do t'u zbulojnë tema për të diskutuar. Gjithashtu, mund të japin dhe elemente për një fushatë sensibilizimi në komunitet dhe më gjerë. Shfytëzoni këto raste që ju jepen, duke përfshirë, nëse është e mundur, dhe mjetet lokale ose kombëtare të medias. Ky do të që një tregues i rëndësishëm për vlerësimin e modulit.

Ky modul, në mënyrë të thjeshtë, tregon sa e vështirë është të trajtosh punën e fëmijëve, që është një dukuri e fshehtë dhe që opinioni publik, për arsye të ndryshme, nuk e vlerëson sa e si duhet. Derisa të rinjtë të marrin një informacion të përshtatshëm për punën e fëmijëve, është e nevojshme të nxisni një ndërgjegjësim në rritje për problemin.

Mësimi më kryesor që mund të nxirret nga ky modul, është se pjesëmarrësit fillojnë të kuptojnë sa e rëndësishme është t'u shkojnë deri në fund problemeve të shoqërisë, në mënyrë që të nxjerrin në dritë të vërtetën për atë që ndodh në botë. Kjo do të thotë që ata nuk duhet t'i besojnë gjithëçkaje që mjetet e komunikimit paraqesin me bujë ose, të paktën, të kuptojnë se duhet të jenë objektive në vlerësimin e informacionit që marrin.

Nëse keni mundësi, kolazhet e përgatitura varini në muret e klasës ose në një mjedis tjetër, që të tjerë të mund t'i shikojnë. Këto krijime janë një formë shumë e mirë për të paraqitur në një publik më të gjerë projektin që zhvillohet. Ftoni në shkollë ose në mjedisin ku zhvillohet projekti, të rinj të tjerë, madje dhe gazetarë që të fotografojnë apo të filmojnë kolazhet e përgatitura dhe t'i japin ato në organet e shtypit që përfaqësojnë.

Imazhet që do të përcillen, përfaqësojnë një qëndrim të caktuar për problemin e punës së fëmijëve dhe është shumë e rëndësishme që komuniteti, pjesë e të cilit janë të rinjtë, të bëjë një vlerësim pozitiv të punës së tyre. Me kolazhet e përgatitura, organizoni një ekspozitë dhe ftoni ta vizitojnë prindër, mësues, përfaqësues të OJF-ve, subjekte private, përfaqësues të medias lokale etj. Organizoni një shitje me ankand të punimeve me qëllim që fondet e mbledhura t'u shërbejnë për zhvillimin e veprimtarive të tjera. Ndoshta, për herë të parë, komuniteti njihet me këtë projekt. Pra, shfrytëzoheni këtë rast për të përgatitur terrenin dhe për të bërë të njohur veprimtari të tjera që do të bëni për përfshirjen e komunitetit. Në këtë mënyrë, grupi i të rinjve me të cilët keni punuar, do të kuptojë qëllimin afatgjatë të punës së vet.

Pas përfundimit të këtij moduli, është mirë të vazhdoni me realizimin e modulit "Figura".

# Shënime

A series of horizontal dotted lines for writing notes.